

LENGARICA & ENERGY sh.p.k

**Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2011**

✓

PËRMBAJTJA

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	8 - 17

LENGARICA & ENERGY sh. p. k.
Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2011

(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
AKTIVET			
I AKTIVET AFATSHKURTRA			
1 Aktive monetare	4	26,037,182	5,081,392
2 Derivate dhe aktive të mbajtura për tregtim			
(i) Derivativet		-	-
(ii) Aktive të mbajtura për tregtim		-	-
Totali 2		-	-
3 Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
(i) Llogari të arkëtueshme		-	-
(ii) Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5	16,316,641	4,948,317
(iii) Të tjera instrumenta borxhi		-	-
(iv) Investime financiare të tjera	6	300,000	-
Totali 3		16,616,641	4,948,317
4 Inventari			
(i) Lëndët e tjera		-	-
(ii) Produkte dhe shërbime në proces		-	-
(iii) Produkte të gatshme dhe mallra për tu shitur		-	-
(iv) Mallra për rishitje		-	-
(v) Parapagesat për furnizime		-	-
Totali 4		-	-
5 Aktive biologjike		-	-
6 Aktive afatshkurtra të mbajtura për rishitje		-	-
7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	210,000	-
TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)		42,863,823	10,029,709
II AKTIVET AFATGJATA			
1 Investime financiare afatgjata			
(i) Pjesëmarrje dhe zotërime		-	-
(ii) Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		-	-
(iii) Aksione dhe letra me vlerë të tjera		-	-
(iv) Llogari të arkëtueshme afatgjata		-	-
Totali 1		-	-
2 Aktive afatgjata materiale			
(i) Toka		-	-
(ii) Ndërtesa		-	-
(iii) Makineri dhe pajisje		-	-
(iv) Aktive të tjera afatgjata materiale	8	135,432,667	20,886,219
Totali 2		135,432,667	20,886,219
3 Aktive biologjike afatgjata		-	-
4 Aktive afatgjata jomateriale			
(i) Emri i mirë		-	-
(ii) Shpenzimet e zhvillimit dhe kërkimit		-	-
(iii) Aktive të tjera afatgjata jomateriale		-	-
Totali 4		-	-
5 Kapitali aksionar i papaguar		-	-
6 Aktive të tjera afatgjata		-	-
TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)		135,432,667	20,886,219
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		178,296,490	30,915,928

LENGARICA & ENERGY sh. p. k.
Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2011

(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	DETYRIMET AFATSHKURTRA		
1	Derivativet	-	-
2	Huamarrjet		
(i)	Huamarrjet dhe bonot afatshkurtra	-	-
(ii)	Ripagesat e huamarrjeve afatgjata	-	-
(iii)	Bono thesari të konvertueshme	-	-
	Totali 2	-	-
3	Huatë dhe parapagimet		
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	9 40,125,501	6,093,228
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve	10 1,464,421	476,852
(iii)	Detyrime tatimore	11 8,410	118,225
(iv)	Detyrime të tjera	12 19,062,854	2,764,821
(v)	Parapagimet	-	-
	Totali 3	60,661,186	9,453,126
4	Grantet dhe të ardhura të shtyra	-	-
5	Provizionet afatshkurtra	-	-
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA(I)	60,661,186	9,453,126
II	DETYRIMET AFATGJATA		
1	Huatë afatgjata		
(i)	Huate bankare, bonot e thesarit dhe qiraja financiare	13 148,516,170	26,227,530
(ii)	Bono thesari të konvertueshme	-	-
	Totali 1	148,516,170	26,227,530
2	Huamarrje të tjera afatgjata	-	-
3	Provizionet afatgjata (rezerva zëvendësimi)	-	-
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra	-	-
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA (II)	148,516,170	26,227,530
	TOTALI I DETYRIMEVE	209,177,356	35,680,656
III	KAPITALI		
1	Kapitali aksionar	14 100,000	100,000
2	Prime të kapitalit	-	-
3	Rezerva statutore	-	-
4	Rezerva ligjore	-	-
5	Rezerva të tjera	-	-
6	Humbja e akumuluar (Humbja -)	(4,864,728)	(511,344)
7	Fitimi dhe humbja e periudhës (Humbja -)	(26,116,138)	(4,353,384)
	TOTALI I KAPITALIT (III)	15 (30,880,866)	(4,764,728)
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I,II,III)	178,296,490	30,915,928

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011 janë autorizuar nga menaxhimi dhe firmosur më 16 Mars 2012 nga:

Wolfgang Kröpfl
 Administrator



Prepared by:
 KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania
KPMG Albania Sh.p.k.

LENGARICA & ENERGY sh. p. k.**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011***(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	Shënime	2011	2010
1	Shitjet neto	-	-
2	Të tjera shitje dhe shërbime	-	-
3	Ndryshime në produktet e gatshme dhe prodhimin në proces	-	-
4	Materialet dhe mallrat e konsumuara	-	-
5	Shpenzimet e personelit	(2,008,892)	(679,544)
	<i>Pagat</i>	16	(1,799,360)
	<i>Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore</i>	16	(209,532)
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet	8	(94,275)
7	Shpenzime të tjera	17	(19,774,630)
8	Totali i shpenzimeve (4,5,6,7)	(21,877,797)	(3,637,771)
9	Humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)	(21,877,797)	(3,637,771)
10	Të ardhurat dhe shpenz. financ. nga njësitë e kontrolluara	-	-
11	Të ardhurat dhe shpenz. financ. nga pjesëmarrjet	-	-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		
12.1	Të ardh. dhe shpenz. nga investime të tjera afatgj.	-	-
12.2	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	18	(5,446,883)
12.3	Fitim / Humbja nga kurset e këmbimit	19	1,537,129
12.4	Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera financiare	20	(328,587)
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.2+/-12.3+/-12.4)	(4,238,341)	(715,613)
14	Fitimi/(Humbja) para tatimit (9+/-13)	(26,116,138)	(4,353,384)
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	21	-
16	Fitimi /(humbja) neto për periudhën	(26,116,138)	(4,353,384)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

LENGARICA & ENERGY sh.p.k
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2011
(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)

	Kapitali i paguar aksionar	Primet e kapitalit	Aksionet e thesarit	Rezerva statutore dhe ligjore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	100,000	-	-	-	(511,344)	(411,344)
Humbja neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(4,353,384)	(4,353,384)
Dividendët e deklaruar	-	-	-	-	-	-
Rritja e rezervave të kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	100,000	-	-	-	(4,864,728)	(4,764,728)
Humbja neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(26,116,138)	(26,116,138)
Dividendët e deklaruar	-	-	-	-	-	-
Rritja e rezervave të kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	100,000	-	-	-	(30,980,866)	(30,880,866)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

LENGARICA & ENERGY sh.p.k**Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011***(Shumat janë të shprehura në Lek, përvecse ku parashikohet ndryshe)*

Pasqyra e flukseve monetare – metoda indirekte	Shënime	2011	2010
Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Humbja pas tatimit		(26,116,138)	(4,353,384)
Rregullime për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	8	94,275	-
Të ardhura nga investimet		-	-
Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	18	5,446,883	516,858
(Rritje) / rënie në tepricën e llogarive të arkëtueshme dhe kërkesave të tjera të arkëtueshme		(11,668,324)	-
(Rritje) / rënie në tepricën e inventarit		-	-
Rritje / (rënie) në tepricën e llogarive të pagueshme dhe detyrimeve të tjera		48,873,573	8,741,482
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		16,630,269	(581,383)
Interes i paguar		(3,122,826)	-
Tatim mbi fitim i paguar	21	(210,000)	-
<i>Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>		<i>13,297,443</i>	<i>(581,383)</i>
Flukse monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje prona, makineri dhe pajisje	8	(114,640,723)	(20,886,219)
Të ardhura nga shitja prona, makineri dhe pajisje		-	-
Interes i arkëtuar	18	10,430	21,164
Dividendë të paguar		-	-
<i>Mjete monetare neto të përdorura në aktivite investuese</i>		<i>(114,630,293)</i>	<i>(20,865,055)</i>
Fluksi monetar nga veprimtaritë financuese			
Emetimi i kapitalit aksionar		-	-
Të ardhura nga huamarrjet afatgjata	13	122,288,640	26,227,530
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		-	-
<i>Mjete monetare neto të përdorura në aktivite financuese</i>		<i>122,288,640</i>	<i>26,227,530</i>
Rritja / (rënia) ne mjetet monetare dhe ekuivalentë të saj			
		20,955,790	4,781,092
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fillim të periudhës	4	5,081,392	100,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fund të periudhës	4	26,037,182	5,081,392

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

LENGARICA & ENERGY sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria") u themelua në përputhje me vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), datë 26 qershor 2008.

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar është 100,000 Lek.

Shoqëria është përfshirë kryesisht në aktivitetet që vijonë: projektimi, ndërtimi dhe transferimi i hidrocentralit tek autoriteti kontraktues.

Përfaqesuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Wolfgang Kröpfl.

Më 31 dhjetor 2011, Shoqëria ka qënë e regjistruar si subjekt i tatueshëm në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT K83026602A. Selia kryesore e saj është në adresën: Rruga "Eqrem Çabej", Nd.6 - H.2, Njesia Bashkiake nr.5, 1022, Tiranë. Numri i të punësuarëve më 31 dhjetor 2011 është 1 (2010: 1).

MARRËVESHJA E KONCESIONIT - TERMA TË RËNDËSISHËM

Në përputhje me Nenin 100 të Kushtetutes së Shqipërisë dhe Ligjin Nr. 9663 "Për Koncesionet" Dt. 18.12.2006, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 543, dt. 01.05.2008, "Për Marrëveshjen e Koncesionit të tipit BOT (Ndërtim – Shfrytëzim – Transferim) midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ("METE" ose Autoriteti Kontraktues") dhe Hasi Energji Sh.p.k. ("Koncesionari"). Marrëveshja e koncesionit u ndryshua më 25.04.2009. Ky ndryshim u aprovua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 476, dt 06.05.2009. Kontrata e ndryshuar është për ndërtimin e një hidrocentrali "Lengarica" me një fuqi prej 8,906 KW.

Në përputhje me Marrëveshjen e Koncesionit, Koncesionari ka krijuar Shoqërinë Koncesionare, Lengarica & Energy sh.p.k.

Hidrocentralet duhet të përfundohen dhe të jenë të gatshëm për përdorim brenda 36 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimit të Marrëveshjes. Sipas kushteve të marrëveshjes, Koncesionari do të shfrytëzojë hidrocentralet për një periudhë prej 35 vjetësh, duke filluar nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes. Pas kësaj periudhe, hidrocentralet do ti transferohen METE-s pa pagesë, së bashku me ndonjë aktiv tjetër të ndërtuar në terrenin e koncesionit.

Autoriteti Kontraktues garanton blerjen e energjisë elektrike për 15 vitet e para nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare – KESH sh.a. Tarifa koncesionare është 2.1% e energjisë së prodhuar.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe çmuarjet e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktike mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentë të saj, të tjera llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme.

Fillimisht Shoqëria i njej mjetet monetare dhe ekuivalentë të saj, llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në datën e krijimit. Të gjitha instrumentat e tjerë financiarë (përfshirë aktivitetet e njohura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimeve apo humbjeve) janë njohur fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivitetet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuale të aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjitha risqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitetit financiar transferohen. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara që është krijuar apo përfutur prej Shoqërisë njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në bilanc vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompesuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përftojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë llogaritë rrjedhëse në bankë. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjete monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozita me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar minus humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe evazioni ose thyerja e ligjit në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale. Aksionet janë klasifikuar si zë i kapitalit.

3.3 Prona, makineri dhe pajisje

i. Njohja dhe matja

Zërat e prona, makineri dhe pajisje janë të matura me koston minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Kostot e borxhit nuk janë kapitalizuar.

Në rastet kur pjesë të prona dhe pajisje kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të prona, makineri dhe pajisje.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën kontabël (neto) dhe këto përfshihen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do të vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat dhe shpenzimet sipas rastit të ndodhur.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Prona, makineri dhe pajisje (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i prona, makineri dhe pajisje është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke filluar nga dita e pare e muajit pas muajit të blerjes së tyre. Punime në proces nuk janë amortizuar. Mobiljet dhe pajisjet e zyrës janë amortizuar duke përdorur një normë amortizimi prej 20%. Pajisjet infomatike janë amortizuar duke përdorur një normë amortizimi prej 25%.

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivet Financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që kanë patur një ndikim në flukset të ardhshme të vlerësuara të parasë të aktivit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël (neto) e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhurë nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit.

3.8 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

Shoqëria nuk ka aplikuar tatimin e shtyrë në këto pasqyra financiare si përmendet në SKK 11 *Tatimi mbi fitimin*, pasi zbatimi i tij nuk është i detyrueshëm.

4. AKTIVE MONETARE

Aktivet monetare më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Llogari rrjedhëse - Raiffeisen Bank (LEK)	68,764	-
Llogari rrjedhëse - Raiffeisen Bank (EUR)	25,968,418	5,081,392
TOTALI	26,037,182	5,081,392

5. TË TJERA LLOGARI TË ARKËTUESHME

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
TVSH e zbritshme	16,316,641	3,829,856
AMER - AUSTRIA	-	1,118,461
TOTALI	16,316,641	4,948,317

6. INVESTIME TË TJERA FINANCIARE

Investime të tjera financiare më 31 dhjetor 2011 paraqesin një kontratë garancie të mbajtur nga Raiffeisen Bank në favor të Agjensia e Shërbimit Arkeologjik e cila maturohet më 31 dhjetor 2013.

7. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Parapagim i tatim fitimit	210,000	-
TOTALI	210,000	-

LENGARICA & ENERGY sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011
(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)

8. AKTIVE TË TJERA AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata material më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 përbehen si vijon:

	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje informatike	Aktive në proces	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 dhjetor 2010	438,197	-	20,448,022	20,886,219
Shtesa	-	63,670	114,577,053	114,640,723
Gjendja më 31 dhjetor 2011	438,197	63,670	135,025,075	135,526,942
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2010	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	87,640	6,635	-	94,275
Gjendja më 31 dhjetor 2011	87,640	6,635	-	94,275
Vlera kontabël neto				
Më 31 dhjetor 2010	438,197	-	20,448,022	20,886,219
Më 31 dhjetor 2011	350,557	57,035	135,025,075	135,432,667

Aktive në proces

Gjatë vitit shoqëria ka kapitalizuar kostot e lidhura me ndërtimin e hidrocentraleve të cilat përfaqësojnë pagesat për përgatitjen e projektit, pagesa të ngjashme dhe tarifa të tjera për shërbime profesionale të lidhura me ndërtimin.

9. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORIT

Të pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
enso hydro GmbH (shënimi 21)	24,588,917	-
e2 group umweltengineering GmbH	-	1,182,987
Babasi Co Sh.p.k	14,442,120	-
International Business Agency	524,879	2,352,877
Stangl Ingenieurbuero	-	1,785,692
Të tjera	569,585	771,672
TOTALI	40,125,501	6,093,228

10. TË PAGUESHME NDAJ PUNONJËSVE

Të pagueshme ndaj punonjësve përfaqësojnë detyrimet për pagat.

11. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	-	23,464
Detyrime të tjera ndaj shtetit	-	86,351
Tatimi mbi të ardhurat personale	8,410	8,410
TOTALI	8,410	118,225

12. DETYRIME TË TJERA

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Detyrime ndaj Hasi Energji (shënimi 21)	399,700	399,700
Shpenzime të përlllogaritura	15,396,454	1,623,610
Interesa të përlllogaritura	2,876,414	541,927
Detyrime të tjera	390,286	199,584
TOTALI	19,062,854	2,764,821

13. HUA, BONO THESARI DHE QIRA FINANCIARE

Hua, bono thesari dhe qira financiare përfaqësojnë dy (2010: katër) hua me aksionarin enso hydro me një interes vjetor prej 7%, i pagueshëm në baza tremujore. Huatë duhet të shlyhen jo më vonë se 31 dhjetor 2014.

(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)

14. KAPITALI AKSIONAR I PAGUAR

Më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 kapitali aksionar është 100,000 Lek dhe përbëhet nga 100 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek për aksion. Më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 struktura e kapitalit ka qënë si më poshtë:

	31 dhjetor 2011		31 dhjetor 2010	
	Kapitali aksionar	%	Kapitali aksionar	%
Hasi Energji	20,000	20%	42,000	42%
enso hydro	80,000	80%	58,000	58%
TOTALI	100,000	100%	100,000	100%

15. KAPITALI NETO NEGATIV

Shoqëria është në fazën e fillimit dhe ajo ka asete neto negative me vlerë 30,521,389 Lek (2010: 4,764,728 Lek). Shoqëria ka mbështetjen e vazhdueshme të aksionarëve të saj dhe aksionari kryesor ka një hua afatgjatë me shoqërinë me vlerë 148,516,170 Lek më 31 dhjetor 2011 (2010: 26,227,530 Lek) e cila pritët të mbulojë më shumë se detyrimet e vazhdueshme në të ardhmen e afërt.

16. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit përbëhen nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010
Pagat	1,799,360	582,300
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	209,532	97,244
TOTALI	2,008,892	679,544

17. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010
Shërbime	10,294,350	2,125,800
Kontrata sigurimi	2,632,435	-
Shpenzime qiraje	4,029,936	27,336
Shpenzime për administrimin e zyrës	193,555	426,199
Shpenzime uji, drite etj	18,787	-
Telefon	393,446	-
Mirëmbajtje dhe riparime	92,197	30,000
Shpenzime përfaqësimi	462,922	-
Karburant	85,036	16,745
Gjoha dhe penalitete	10,074	126,443
Taksa të tjera	18,120	34,120
Udhëtime dhe akomodime	1,303,872	43,612
Të tjera	239,900	127,972
TOTALI	19,774,630	2,958,227

*(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)***18. TË ARDHURA DHE SHPENZIME NGA INTERESAT**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010
Të ardhura nga interesat nga llogaritë rrjedhëse	10,430	21,164
Shpenzime interesi për huanë nga enso hydro	(5,457,313)	(538,022)
TOTALI	(5,446,883)	(516,858)

19. FITIMI/(HUMBJA) NGA KURSET E KËMBIMIT

Fitimi / Humbja nga kurset e këmbimit përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010
Fitimet nga kurset e këmbimit	3,755,901	18,779
Humbjet nga kurset e këmbimit	(2,218,772)	(139,073)
TOTALI	1,537,129	(120,294)

20. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë komisionet bankare të paguara gjatë vitit.

21. SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri me një normë për tatimin mbi fitimin prej 10% për vitin 2011 (2010: 10%). Deklaratat tatimore dorëzohen cdo vit. Shoqëria ka parapaguar gjatë vitit 2011 tatim fitim për vlerën 210,000 Lek (referoju shënimit 7).

Shoqëria rezulton me një humbje fiskale dhe kontabël gjatë 2011 dhe 2010. Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria ka të drejtë të mbartë humbjet tatimore për një periudhë tre vjecare.

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
(Humbja) e vitit	(26,116,138)	(4,353,384)
Shpenzime të pazbritshme	8,155,499	868,752
(Humbjet) fiskale	(17,960,639)	(3,484,632)
Tatimi mbi fitimin @ 10%	-	-
Humbjet fiskale të mbartura	(17,960,639)	(3,484,632)

Humbjet fiskale të mbartura më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Humbjet tatimore nga 2009 (e vlefshme deri më 2012)	511,344	511,344
Humbjet tatimore nga 2010 (e vlefshme deri më 2013)	3,484,632	3,484,632
Humbjet tatimore nga 2011 (e vlefshme deri më 2014)	17,960,639	-
TOTALI	21,956,615	3,995,976

*(Shumat janë të shprehura në Lek, përveçse ku parashikohet ndryshe)***22. PALËT E LIDHURA**

Në datën e mbylljes së bilancit, shumat që vijojnë u korrespondojnë aksionarëve dhe drejtuesve kryesor të Shoqërisë:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Detyrime ndaj palëve të lidhura		
Hua nga enso hydro	148,516,170	24,978,600
Të pagueshme ndaj enso hydro (shënimi 9)	24,588,917	-
Detyrime ndaj Hasi Energji (shënimi 12)	399,700	399,700
TOTALI	173,504,787	25,378,300
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010
Shpenzime ndaj palëve të lidhura		
Shpenzime interesi për huanë e enso hydro (shënimi 17)	5,457,313	538,022
Kompensim ndaj drejtuesve kryesor (shënimi 15)	1,799,360	582,300
TOTALI	7,256,673	1,120,322

23. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA**Çështje ligjore**

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështjeje gjyqësore, pretendimi, apo konflikti që rrjedhin nga aktiviteti normal i biznesit.

Angazhimet për qiratë operative

Më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 Shoqëria ishte palë në një marrëveshje për qira operative në lidhje me qiranë e zyrës. Marrëveshja e qirasë së zyrës maturohet më 15 janar 2013.

Pagesat minimale të ardhshme janë si më poshtë:

	2011	2010
Brenda një viti	2,189,304	2,479,680
Pas një por jo më shumë se pesë vitesh	127,709	2,658,768
Totali	2,317,013	5,138,448

Shpenzimi i qirasë për këtë qira operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 ka vlerën 2,421,800 Lek dhe përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (shënimi 15).

24. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.